



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.75

Prishtinë, më 22.12.2016, në orën 18:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,  
KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Në mbledhje morën pjesë:** Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi  
Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik dhe Shukrije Bytyqi.

**Mungoi** Sërgjan Popoviq

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.**

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

**1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas pikës së vetme të rendit të ditës.

**1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017**

Nait Hasani, tha se shqyrtimi i sotëm i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 bëhet me propozim të deputetit Shpejtim Bulliqi dhe me përkrahjen anëtarëve të Komisionit.

Komisioni vlerësoi se rritja e buxhetit për projektin e ndërtimit të objektit të FSHMN nga 200,000 euro në 1,200,000 euro është i një rëndësie të veçantë, bazuar në faktin se FSHMN aktualisht nuk ka hapësirë dhe kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit arsimor. Shuma prej 1,000,000 euro për projektin e ndërtimit të objektit të FSHMN bartet nga nënprogrami “Shpenzimet e Paparashikuara” me kod 232, në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe vendosi që Komisionit për Buxhet dhe Financa, t’ia paraqet këtë :

### **Amendamenti 1**

1. Në Organizatën Buxhetore ”Universiteti i Prishtinës” me kod 242000, në tabelën 3.2. nënprogrami i Universitetit të Prishtinës me kod 90400, bëhen ndryshimet si në vijim: Projekti “Ndërtimi i Objektit për FSHMN” me kod 13980, shuma prej 200,000 euro ndryshohet në shumën 1,200,000 euro.
2. Në Organizatën Buxhetore “Shpenzimet e Paparashikuara” me kod 232, bëhen ndryshimet si në vijim: Nënprogrami “Shpenzimet e Paparashikuara” me kod 232, në tabelën 3.1 në kategorinë e shpenzimeve kapitale, shuma prej 4,000,000 euro, ndryshohet në shumën 3,000,000 euro.

Amendamenti i propozuar u përkrah njëzëri nga anëtarët e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 18:30.

***E përgatiti:***

***Njësia për Mbështetjen e Komisionit.***

Kryetari i Komisionit,

-----  
Nait Hasani